



Te premten, dy dite para sfides me Besen, trajneri I Partizanit Hasan Lika ka folur per mediat. Skuadra e tij eshte e dyta dhe deshiron te qendroj ne keto pozita ne tabele edhe pas kesaj jave. Perballe Beses, Lika ben me dije se duhet treguar shume kujdes. “Eshte nje ndeshje e veshtire. Kundershtari ka marre rezultate pozitive ne javet e fundit duke luajtur mjaft mire. Ne vijme pas nje humbje dhe ne ndeshjen e rradhes para tifozeve tane nuk duhet te zhgenjejme. Ne duam shume te dalim kampion por jave pas jave do ta shohim si do te zhvillohen ngjarjet”, ka deklaruar Hasan Lika nje nga trajneret me te mire te Superiores qe po merr rezultate pozitive me Partizanin e tij.